



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.295/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Kujtim Pasuli - kryesues, Ramush Bardiqi dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e Isuf Osmani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Podujevës, nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, të paraqitura kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 24.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

HEDHEN TË PASAFATSHME ankesat ZL.Anr.295/2025, ZL.Anr.296/2025, ZL.Anr.297/2025, të datës 22.10.2025, të parashtruara nga Isuf Osmani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Podujevës, nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, të paraqitura kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 22.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesat ZL.Anr.295/2025, ZL.Anr.296/2025, ZL.Anr.297/2025, nga Isuf Osmani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Podujevës, nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, ku në ankesën ZL.Anr.295/2025, thekson se në shkollën “Aleksandër Gjuvani” vendvotimi 1802-01 në Podujevë e cila i ka tri vendvotime, vëzhguesi Mentor Rrahmani gjatë numërimit i ka vërejtur se në vendvotimin 1802-01 kanë qenë 9 vota në emrin e Isuf Osmani me nr.10, në qendrën 1802-02, janë numëruar në vendvotim 7 vota, kurse në vendvotimin 1802-03 kanë qenë 3 vota, kurse në programin e KQZ-së, figurojnë vetëm 10 vota, parashtruesi pretendon se i janë anashkaluar 9 vota.

Në ankesën ZL.Anr.296/2025, thekson se sipas vëzhguesit të tij Mentor Rrahmani se gjatë numërimit ka sjell dokumentin nga vendvotimi 1837-01, në Lluga se janë 4 vota dhe vendvotimin 1837-02 në Lluga 1 votë, kurse kur janë precizuar votat në programin e KQZ-së figuron vetëm një votë. Me tutje thekson se vëzhguesit e tij Mentor Rrahmani dhe Sevdail Azemi e kanë njoftuar për rrjedhën e numërimit të votave, për të cilat thekson se ka mbajtur

evidencë dhe se ka qenë i informuar se nga qendra e numërimit i ka ardhur një numër i madh i votave kurse në procesin e KQZ-së janë me pak vota. Parashtruesi thekson se disa here kam telefonuar në qendër të numërimit në KQZ, Hakif Mehmeti për parregullsitë në futjen e votave në programin e KQZ, mirëpo thekson se i janë përgjigjur se këto shkojnë me ngadalë, dhe se nuk janë procesuar votat që unë pretendoj se më janë marrë. Po ashtu parashtruesi thekson se në ditën e fundit të numërimit kur vëzhguesit kanë sjell evidencën të cilën e kanë mbajtur ishin 355 vota ndërsa në program janë vetëm 345, 10 vota me pak. Parashtruesi i ankesës kërkon të vërtetohet nëse është parregullsi.

Në ankesën ZL.Anr.297/2025, thekson se në bazë të anëtarit të KQZ-së, Adem Osmani i cili ka marr pjesë gjatë numërimit në Bradash shkolla "Nuhi Gashi", në tri qendrat e vendvotimit 1812-01, 1812-02 dhe 1812-03 deklaron se janë 13 (trembëdhjetë) vota, kurse në KQZ në program gjenden vetëm 4 vota, e po ashtu parashtruesi i ankesës thekson se edhe një zyrtar tjetër nga qendra e numërimit i ka telefonuar se janë 13 vota. Tutje në ankese theksohet se nga ky fshat kanë votuar familjar që deklarojnë se kanë votuar, si dhe kërkon që të verifikohen pretendimet e tij për keqpërdorim të votave.

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja thekson se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN).

Në lidhje me pretendimet e palës ankuese për pikën e parë të ankesës për verifikim të votave në vendvotimet e specifikuar më sipër, KQZ, pas analizimit të lëndës, ka konstatuar se ankesa është paraqitur jashtë afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, pasi sipas konfirmimit të ZEKZ-së në komunën e Podujevës, aktiviteti i QKN-së është përmbyllur më datë 17.10.2025, në ora 16:00, ndërsa pala ankesën e ka parashtruar më datë 22.10.2025. Pra nuk është brenda afatit ashtu siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

KQZ, pas pranimit të kërkesës së PZAP, menjëherë ka kontaktuar me KKZ e komunës së Podujevës, duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet si në vijim: "QKN në Podujeve ka filluar punën në procesin e numërimit/verifikimit të votave me date 14 tetor 2025 në ndërrimin e pasdites, dhe ka përfunduar 17.10.2025 në ora 16.00. Procesi ka qene shume transparent dhe nuk kemi pas asnjë ankese".

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZL.Anr.295/2025, ZL.Anr.296/2025, ZL.Anr.297/2025, të datës 22.10.2025 të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën

shenjë e përbashkët ZL.A.nr.295/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pas shqyrtimit të ankesave dhe shkresave të lëndës konstaton se:

- Ankesat janë të pasafatshme

Paneli, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka gjetur se ankesat ZL.Anr.295/2025, ZL.Anr.296/2025, ZL.Anr.297/2025, të parashtruara nga Isuf Osmani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Podujevës, nga radhët e Subjektit Politik PDK, të paraqitura kundër KQZ-së, me pretendimet se i mungojnë votat për të cilat ankuesi ka pasur pritshmëri dhe duke i bazuar nga ato se çfarë i kane deklaruar vëzhguesit, me të cilat pretendime ka kërkuar që të bëhet verifikimi i votave në vendvotimet 1802/01, 1802/02, 1802/03, 1837/01, 1837/02, 1812-01, 1812/02, dhe 1812/03, janë të parashtruara pas afatit të përcaktuar ligjor.

Me dispozitën e nenit 105 paragrafi 1, në mënyrë decitive parashihet se *"Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar," të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.*

Me dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, parashihet që *"Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara", dhe në nën paragrafin 5.16. parashihet që "Për shkeljet e pretenduara gjatë procesit të administrimit dhe numërimit në QKN dhe QNR".*

Neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, parasheh që: *"PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor."*

Në rastin konkret Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesat në PZAP me datë 22.10.2025, ku ka pretenduar se i mungojnë votat dhe ka kërkuar që të verifikohen votat në vendvotimet 1802/01, 1802/02, 1802/03, 1837/01, 1837/02, 1812/03, dhe 1812/02, ndërsa nga të dhënat zyrtare, e po ashtu edhe nga përgjigja e KQZ është vërtetuar se aktiviteti i QKN-së në Komunën e Podujevës, është përmbyllur më datë 17.10.2025, në ora 16:00, ndërsa pala ankesën e ka parashtruar më datë 22.10.2025, me çka vërtetohet se ankesat e ankuesit nuk janë paraqitur brenda afatit ligjor siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, andaj dhe të njëjtat u deshtë që të hedhen si të pasafatshme.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 105 paragraf 1 i LJP-së, nenit 117 paragrafi 3, dhe nenit 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës lidhur me nenin 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.16, nenin 13, paragrafi 2, neni 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullës 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.295/2025 më datën 24.10.2025

Kryesues i Panelit

Kujtim Pasuli



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.